

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
BULEVARDI E ADMINISTRATËS - BULEVARDI E ADMINISTRATËS

Relat/Date: 85
Data/Date: 06.04.2023

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 05.04.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 258, të datës 17.03.2023, në shqyrtimin e parë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 28 të Ligjit për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit Nr. 08/L-025, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027.
2. Projekt-Planit Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e veprimit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 05.04.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2023, pas shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullores për Transportin Rrugor në Komunën e Fushë-Kosovës, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 54, të datës 07.03.2022, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Transportin Rrugor në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit të transportit në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit dhe Drejtorisë së Inspektoratit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së INSPK dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili






REPubLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 05.04.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2023, pas shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullores për Orarin e punës së veprimtarive ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 54, të datës 07.03.2022, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Orarin e punës së veprimtarive ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Orarin e punës së veprimtarive ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për Orarin e punës së veprimtarive ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e caktimit të orarit të punës për subjektet afariste, që e ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për Orarin e punës së veprimtarive ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit dhe Drejtorisë së Inspektoratit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së INSPK dhe Arkivës.**


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVËS



Datë: 05.04.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2023, pas shqyrtimit të Kërkesës nr. 73, të datës 14.03.2023, të paraqitur nga Shefi i Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), nenin 51, paragrafi 51.1, nenin 52, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 3, paragrafi 1 dhe 2, nenin 4, nenin 5, nenin 6, paragrafi 4, të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 34, paragrafi 34.1, shkronja (a), nenin 35, nenin 37, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021


1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.6, të vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa për të realizuar ndërrimin e përfaqësueses së Lëvizjes Vetëvendosje si vijon;
 - 1.1 Për largimin e znj. Eglantina Azemi nga përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa prej shtatë anëtarëve dhe
 - 1.2 Për caktimin e znj. Hasime Kostanica në cilësinë e anëtares së re të Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë si: shqyrtimin e politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raportit nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Udhëheqëses së Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa, Udhëheqësit të Personelit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 05.04.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2023, pas shqyrtimit të Kërkesës nr. 73, të datës 14.03.2023, të paraqitur nga Shefi i Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), nenin 51, paragrafi 51.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 1 dhe 3, nenin 14, nenin 15, të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, të vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022 për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për të realizuar ndërrimin e përfaqësueses së Lëvizjes Vetëvendosje si vijon:
 - 1.1 Për largimin e znj. Hasime Kostanica nga përbërja e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale prej pesë anëtarëve dhe
 - 1.2 Për caktimin e znj. Doruntina Jashari në cilësinë e anëtares së re të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022, për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë e definuara në nenin 8, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Udhëheqëses së Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale, Udhëheqësit të Personelit dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 05.04.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2023, pas shqyrtimit të Propozimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për Bashkësitë Fetare, në Komunën e Fushë-Kosovës, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç) dhe nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për periudhën prill-dhjetor 2023


1. Për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës, me dokumentacion personal të identifikimit, për periudhën prill - dhjetor 2023, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve 20, programi 18162, në shumën e mjeteve financiare prej: 245.00€, nga buxheti i komunës për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
2. Sigurimi i mjeteve financiare sipas pikës një të vendimit nga buxheti i komunës, për periudhën në fjalë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave e Buxhetit.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit.
4. Për shpenzimin e mjeteve financiare të lejuara nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve 20, programi 18162, përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës, Kishës Ortodokse dhe bashkësive tjera fetare, i raportojnë me shkrim Kuvendit të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, Kishës Ortodokse Serbe në Fushë-Kosovë dhe Arkivës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 05.04.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2023, pas rishqyrtimit të kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, për vendimin Nr. 69, të datës 06.03.2023, sipas shkresës me Nr. 020-245/3, të datës 17.03.2023 dhe shkresës me Nr.1237-2/23, të datës 17.03.2023, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53, të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 19/2016), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e Vendimit Nr. 69, të datës 06.03.2022

1. Për shfuqizimin e vendimit Nr. 69, të datës 06.03.2022, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-245/3, të datës 17.03.2023 dhe shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës me Nr.1237-2/23, të datës 17.03.2023, lidhur me aprovimin e Propozimit Nr. 138, të datës 15.02.2023, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për Njësinë e Zjarrëfiksëve, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 05.04.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2023, pas shqyrtimit të Propozimit për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për taksa komunale, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.1, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për taksa komunale në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për formimin e 'Grupit punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Taksa Komunale në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej njëzet e një anëtarëve si vijon: Laureat Gojnovci, Etnik Berjani, Doruntina Jashari, Migjen Kolshi, Bashkim Krasniqi, Idriz Idrizi, Ekrem Gojnovci, Merita Krasniqi, Besim Tërmmkollli, Blerta Begolli Musolli, Adelina Gashi, Ardit Sekiraqa, Nexhat Bajçinca, Ganimete Berisha, Miranda Sulejmani, Fatlum Berisha, Sulejman Shabani, Besa Budakova, Besare Sllamniku Aliu, Zoran Kitic dhe Avdyl Krasniqi.
2. Anëtar/e të Grupit Punues nga paragrafi një i këtij vendimi janë edhe: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Shefja e Zyrës Ligjore dhe Zyrtari i Lartë për Kuvend dhe Komitete, për monitorimin e rregullsisë së hartimit të aktit normativ, në përputhje me dispozitat ligjore, të ligjeve dhe udhëzimet administrative.
3. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues, sipas pikës një dhe dy, të këtij vendimi është hartimi i Projekt-Rregullores për Taksa Komunale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

